

Sektor i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 58/2006...96/2019), të nenit 68 të Rregullores gjyqësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr.66/2013), dhe të nenit 41 nga Rregullorja e punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/1998 dhe 21/2009), në seancën e mbajtur më 28.09.2020, miratoi si vijon:

MENDIM JURIDIK

Kreditori duke mos paraqitur informata për llogarinë e tij të transaksionit, me kërkesë të debitorit pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, dhe para se të bëhet i përmbarueshëm, që është përmbushja e një detyrimi financiar, parandalon përmbushjen e një sjelljeje të tillë, dhe kështu bie në vonesë sipas nenit 314 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie obliguese, nga i cili moment kamata pushon të rrjedhë në përputhje me nenin 315 paragrafi 2 nga i njëjti ligj.

A r s y e t i m

Sektor i praktikës gjyqësore pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me shkresë drejtuar Sektorit të veprave civile dorëzoi konkluzion që Sektor i të shqyrtojë për kërkesën e parashtruar nga PP, për çështjen juridike: "Në qoftë se në një situatë kur debitori, pas një aktgjykimi të plotfuqishëm, por para se të bëhet i përmbarueshëm, i është drejtuar kreditorit me shkrim dhe nga ai ka kërkuar informata të nevojshme për përmbushjen vullnetare të detyrimit me të cilin ai është i obliguar, duke mos paraqitur informatat e kërkuara ai ra në një vonesë, në kuptim të dispozitave të nenit 314 paragrafi 1 dhe nenit 315 paragrafëve 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet obliguese.

Konkluzionin, Sektor i praktikës gjyqësore e miratoi duke u udhëhequr nga fakti i padiskutueshëm se për të njëjtën çështje juridike, ekzistojnë vendime të ndryshme gjyqësore, respektivisht gjatë gjendjes së njëjtë faktike dhe juridike gjykatat veprojnë ndryshe në zbatimin e nenit 314 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie obliguese.

Në fakt, Gjykata e apelit Gostivar në aktvendimin GZH.nr. 1341/18 nga data 02.11.2018 për të njëjtën çështje juridike nxjerr konkluzion se kreditori nuk ka rënë në vonesë, përderisa Gjykata e apelit Manastir në aktvendimin GZH.nr. 703/12 ka shprehur mendim të kundërt.

Gjykata e apelit Shkup – Sektor civil konstaton se kreditori ka rënë në vonesë dhe nuk ka të drejtë për kamatë të borxhit kryesor me mungesën e informatave për llogarinë e transaksionit. Sektor ekonomik pranë Gjykatës së apelit Shkup, ka

miratuar konkluzion, me të cilin pajtohet me qëndrimin e shprehur të Gjykatës së apelit Gostivar.

Gjykata e apelit Shtip – sektori civil më 16.09.2019 për të njëjtën çështje juridike miraton konkluzion se kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë kamatë të borxhit kryesor nga momenti kur nuk ka dorëzuar informata për llogarinë e transaksionit kur ka pasur vonesë.

Nga e ekspozuara, dhe për sigurimin e barazisë në zbatimin e nenit 314 paragrafi 1 dhe të nenit 315 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhënie obliguese, Sektori i veprave civile pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konstaton se është e nevojshme që për çështjen juridike të parashtruar të miratojë mendim juridik.

Në qoftë se, niset nga përmbajtja e nenit 314 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie obliguese, sipas të cilës dispozitë kreditori ka vonesë në qoftë se pa ndonjë arsye të bazuar refuzon të pranojë plotësimin ose në qoftë se e pengon me sjelljen e vet, mund të nxirret konkluzion se deri në vonesë kreditore (MORA CREDITORIS) arrihet jo vetëm kur do të refuzojë pranimin e plotësimit pa arsye të bazuar, por edhe me pengimin e plotësimit të tij me sjelljen e tij.

Në këtë drejtim në doktrinën juridike, por edhe në praktikën gjyqësore nuk ka dilema se kreditori bie në vonesë në qoftë se nuk ndërmerr veprime paraprake të përcaktuara pa të cilat debitori nuk mund të plotësojë detyrën, dhe me atë në të njëjtën kohë ndërpritet vonesa debitore (MORA DEBITORIS).

Në bazë të së ekspozuarës, vijonte që Sektori i veprave civile të miratojë mendimin juridik.

**Gjykata supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile**